



Përgjigjet ndaj Komenteve (KOSTT)

Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike

SHTE6 (2012-2013)

Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara

DEKLARATË

Këto përgjigje janë përgatitur nga ZRRE-ja vetëm për qëllime informative. Dokumenti nuk duhet të konsiderohet se paraqet vendim të ZRRE-së.

20 qershor 2012



Përmbajtja

1	Hyrje.....	3
2	Struktura e këtij dokumenti	3
3	Alokimi i kostos lidhur me nënstacionet 110kV	3
4	Shpenzimet e personelit	4
5	Kostot tjera operative.....	5
6	Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit	5
7	Shpenzimet lidhur me kontestin KEK-KOSTT.....	6
8	Situata financiare e KOSTT-it në vitin 2011	6
9	Kompenzimet për humbjet në transmision.....	6
10	Komentet e përgjithshme	7
11	Komentet teknike.....	7
12	Propozimet e ZRRE-së.....	7



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është aktualisht në proces të kryerjes së Shqyrtimit të gjashtë të shqyrtimit të tarifave për energji elektrike (SHTE6).

Ky Raport jep përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të pranuar në lidhje me Raportin e vet të Konsultimit të lëshuar, përkitazi me aplikacionet e parashtruara në ZRRE nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut në Kosovë sh.a. (KOSTT) për aprovim të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që mund të mbulohen nga bizneset e licencuara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST) dhe Operatorit të Tregut (OT).

Aplikimet e pranuar janë publikuar në ueb faqen e ZRRE-së së bashku me Raportin e Konsultimit, komentet e pranuar për të dhe këtë Raport të përgjigjeve.

Qëllimi i këtij Dokumenti të përgjigjeve është t'u komunikojë palëve të interesit qëndrimet e ZRRE-së lidhur me komentet e pranuar dhe propozimet e ZRRE-së lidhur me të hyrat maksimale të lejuara. Këto propozime shqyrtohen nga Bordi i ZRRE-së në një takim publik para lëshimit të vendimit.

Vendimi i lëshuar nga ZRRE do të përcaktojë MAR për bizneset e OST-së dhe OT-së në kuadër të KOSTT-it. Ngarkesat që do të zbatohen nga këto biznese do të përcaktohen me licenca relevante, me kusht që këto janë konform metodologjisë së ngarkesave të aprovuar nga ZRRE.

2 Struktura e këtij dokumenti

Komentet e vetme të pranuar lidhur me shqyrtimin e ZRRE-së dhe propozimet fillestare mbi MAR-in për bizneset e OST-së dhe OT-së të KOSTT-it, janë dhënë nga vetë KOSTT-i. Duke marrë parasysh këtë, për lehtësim të punës, ky dokument është organizuar sipas titujve të komenteve të KOSTT-it. Për çdo titull, përmbledhen argumentet e prezantuara nga KOSTT-i, të pasuara nga përgjigjet e ZRRE-së ndaj tyre. Për informata më të plota, lexuesit referohen te KOSTT-i¹. Pjesa e fundit e dokumentit jap draft propozimet e ZRRE-së.

3 Alokimi i kostos lidhur me nënstacionet 110kV

KOSTT-i komentoi se një protokoll i përbashkët me të cilin rregullohet transferi i aseteve 110kV nga KEK-u te KOSTT-i² në KEK është nënshkruar më 29 shkurt 2012. Rrjedhimisht, më 12 mars 2012, ZRRE ka pranuar kërkesën e KEK-ut për aprovim të transferim të këtyre aseteve. Vlerat përfundimtare i janë dhënë ZRRE-së më 28 maj 2012.

¹ Në dispozicion në ueb faqen e ZRRE-së në www.ero-ks.org në menynë Çmimet dhe tarifat.

² Në përputhje me Vendimin e Qeverisë 10/29 e datës 3 gusht 2011.



Duke marrë parasysh këtë, ZRRE propozon ndryshimin e të hyrave të lejuara për biznesin e OST-së të KOSTT-it për të marrë parasysh këtë transfer të asetëve. Rregullimi i propozuar përdor informatat e ofruara nga KEK-ut në pajtim me KOSTT-in dhe të cilat janë si në vijim:

- Vlera bruto e asetëve që duhet të transferohen është €14.873 milionë ndërsa zhvlerësimi akumuluar në këto asete është €3.752 milionë dhe vlera neto e granteve të shtyera (mbi të cilat nuk ka kthim të lejuar) është 5.092 milionë. RAB-i neto i OST-së, është rritur për €5.993 milionë.
- Vlera bruto e asetëve pas 2006 që duhet të transferohen është €9.637 milionë ndërsa amortizimi i akumuluar në këto asete është €2.421 milionë dhe vlera neto e granteve të shtyera është €3.885 milionë. RAB-i i OST-së, i përdorur për të llogaritur kthimin e lejuar, është rritur për €3.355 milionë.
- Krahas asetëve, 130 punëtorë do t'i transferohen KOSTT-it nga KEK-u. Pagat e përgjithshme vjetore për këta punëtorë është €875,734. Të hyrat e lejuara të KOSTT-it janë rritur për shumë koresponduese .
- Kostot vjetore të mirëmbajtjes që asocohen me transferin e asetëve vlerësohen të jenë €250,000. Të Hyrat e Lejuara të KOSTT janë rritur për të njëjtën vlerë.

Përveç kësaj, sasia e humbjeve të lejuarar për KOSTT-in është rritur për 13 GWh. Kjo përfaqëson humbjet e ndërlidhura me këto asete 110 kV, duke marrë parasysh pritjet e ZRRE-së në përmirësimin e humbjeve të transmisionit përgjegjësi që tash transferohet nga KEK-ut te KOSTT-i.

4 Shpenzimet e personelit

KOSTT-i komenton se kostoja e stafit në vitin 2011 nuk përfshin kostot e punëtorëve shtesë të rekrutuar në vitin 2011 përkundër faktit që ky plan rekrutimi është diskutuar në mënyrë intensive me ZRRE-në para ETR5 me të cilën janë përcaktuar të hyrat e lejuara për vitin 2011. KOSTT-i komenton se një rritje e madhe në koston për punëtorë e propozuar për vitin 2012 përfshin koston e këtyre punëtorëve shtesë dhe se, nëse nuk lejohet rritja e plotë, shpenzimet e punëtorëve duhet të rriten minimumi në përputhje me CPI-në (Indeksi i Çmimeve të Konsumit) e Kosovës (raportuar nga KOSTT-i si 7.3% në 2011).

ZRRE pranon se KOSTT-i ka rekrutuar punëtorë shtesë gjatë vitit 2011 por vë në pah se diskutimi i këtyre planeve nuk mund supozohet si aprovim i ZRRE-së për to. ZRRE gjithashtu cek se KOSTT-it mund t'i shkaktohen shpenzime shtesë për punëtor pas transferimit të përgjegjësisë për asetet 110kV në KOSTT. ZRRE gjithashtu vë në pah se pret që KOSTT-i të kërkojë efikasitet në shpenzimet e veta të punëtorëve dhe se KEK-u, i cili punon në një industri të ngjashme, nuk e ka ndjerë të nevojshme të kërkojë rritje në shpenzime të punëtorëve të barazvlefshme me inflacionin. ZRRE, prandaj, propozon të vazhdojë të lejojë shpenzimet bazë të punëtorëve barazi me nivelin e propozimeve fillestare prej €2.585 milionë. Kësaj do t'i shtohen shpenzimet shtesë të ndërlidhura me personelin e transferuar nga KEK-u te KOSTT-i (shih më lartë).



5 Kostot tjera operative

KOSTT-i komenton se është e paarsyeshme që të përcaktojë kategorinë e “shpenzimeve të tjera operative” në vlerën e tyre reale të vitit 2011 dhe se, si minimum, këto duhet të rriten krahas IÇK në Kosovë. Përveç kësaj, KOSTT-i kërkon përfshirjen e €250,000 të tjera për shpenzimet e ndërlidhura me garantimin e sigurisë fizike të aseteve.

Duke përjashtuar kostot për punëtorë si dhe shpenzimet e ndërlidhura me blerjen e humbjeve në transmision, shuma e lejuar nga KOSTT-i për shpenzimet operative është €2.7 milionë krahasuar me €2.1 të realizuara në vitin 2011 nga KOSTT-i. Kjo përfaqëson një rritje prej 28% për shpenzimet e realizuara apo shumë më lartë sesa rritja e IÇK-së në Kosovë prej 7.3%, e cekur nga vetë KOSTT-i. Duke marrë këtë parasysh, ZRRE nuk sheh nevojë për një rritje të mëtejme në kategorinë specifike të ‘shpenzimeve të tjera operative’.

ZRRE gjithashtu vë në pah se nuk duhet të pritët që kostot të rriten krahas IÇK-së dhe për këtë duhet të lejohen fonde për potencial të përmirësimeve të efikasitetit. Rishqyrtimi i bazës gjegjëse për shpenzimet operative si dhe norma e pritës së efikasitetit do të bëhet para periudhës së parë tarifore shumë-vjeçare, që pritët të hyj në fuqi në prill 2013.

6 Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit

KOSTT-i kërkon që ZRRE të qartësojë se pse MPKK dallon ndërmjet KOSTT-it dhe biznesit të OSSH-së në KEK, kur të dyja janë biznese të rritit që punojnë në kushte të ngjashme të tregut financiar.

MPKK reale para tatimit që vlen për KOSTT-in sipas ETR6 është 11.5%. Kjo është vlera bazë e MPKK për të licencuarit e rregulluar e propozuar nga ZRRE në Raportin Konsultativ mbi vlerat indikative për MPKK të lëshuara në dhjetor 2011. Gjatë procesit të përcaktimit të këtyre vlerave indikative, ZRRE ka theksuar pasiguritë lidhur me llogaritjen e MPKK-së, që do të thotë se janë të mundura një varg vlerash rreth kësaj vlere bazë.

MPKK e barazvlefshme që vlen për OSSH është 12.0%. Kjo është përcaktuar me vendim të Bordit të ZRRE-së më 6 shkurt 2012³. Në marrjen e vendimit, Bordi i ZRRE-së ka marrë parasysh dëshmitë shtesë të ofruara nga këshilltarët e transaksionit të Distribucionit dhe Furnizimit të energjisë elektrike të Kosovës (KEDS) se për suksesin e transaksionit nevojitet një MPKK më i madh. Qartazi, ky arsyetim vlen vetëm për OSSH-në dhe jo për KOSTT-in, të cilat do të mbesin në pronë qeveritare në tërësi.

³ Vendimi V_399_2012i cili gjendet në ueb-faqen e ZRRE-së www.ero-ks.org nën menynë për Aktet dhe Vendimet e ZRRE-së.



7 Shpenzimet lidhur me kontestin KEK-KOSTT

KOSTT-i aktualisht ka kontest me Korporatën Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK) lidhur me pagesën e taksës së transmisionit për vitin 2010. Kontesti i është referuar ZRRE-së, i cili në takimin e Bordit të mbajtur më 29 dhjetor 2011, ka lëshuar vendimin e vet⁴ se KEK-u ia ka borxh KOSTT-it një shumë të papaguar prej €3.88 milionësh dhe se kjo shumë duhet të zbritet nga të hyrat e lejuara të mbuluara nga Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike (PES) përmes tarifës së rregulluar të shitjes me pakicë për 2012-13 (gjegjësisht, atyre të përcaktuar me ETR6). KEK-u ka deklaruar se do të ankohet ndaj vendimit në Gjykatën Supreme.

KOSTT-i komenton se vendimi i ZRRE-së nuk është në përputhje me vendimin e tij mbi tarifatat dhe taksat për vitin 2010 dhe se trajtimi i shumës së kontestuar në vendim është i pasaktë. Ky Raport i përgjigjeve nuk është një mjet i qëlluar për të hyrë në diskutim lidhur me vendimin e ZRRE-së, arsytet e së cilës shpjegohen në tërësi në vendimin e botuar. Në vend të kësaj, çështja relevante për këtë Raport të përgjigjeve është nëse apeli i KEK-ut në Gjykatën Supreme do të thotë se vendimi, i lëshuar nga ZRRE, duhet të suspendohet deri sa të merret vendimi i gjykatës mbi rastin.

Me sa është në dijeni ZRRE, ankesa pranë gjykatës relevant kundër një vendimi të Bordit të ZRRE-së nuk e bën vendimin të pavlefshëm dhe as kërkon suspendimin e saj. Vendimi mbetet në fuqi ashtu siç është lëshuar deri sa gjykata e shpall të pavlefshme apo deri sa nuk kërkon ndryshim, me ç'rast gjykata gjithashtu mund të kërkojë pagesën e dëmeve palëve që janë prekur në mënyrë negative nga vendimi. Duke marrë parasysh këtë, ZRRE do të vazhdojë, me shqyrtimin aktual, të zbatojë vendimin ashtu siç është lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.

8 Situata financiare e KOSTT-it në vitin 2011

Lidhur me këtë kontest, KOSTT-i gjithashtu komenton se do të ballafaqohet me vështirësi të rënda financiare në vitin 2011 po që se nuk do të kishte burime të tjera të të hyrave. ZRRE sërish cek se ky raport i përgjigjeve nuk është një instrument i duhur për të shqyrtuar vendimin e lëshuar nga ZRRE. Arsyetimi për këtë vendim është publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së. Nëse KOSTT-i dëshiron të kontestojë vendimin, duhet ta bëjë këtë në përputhje me procedurat për këtë të parapara në Ligjin për rregullatorin e energjisë.

9 Kompenzimet për humbjet në transmision

KOSTT-i komenton se ZRRE nuk ka përfshirë një ndryshim për dallimet ndërmjet humbjeve reale dhe të lejuara në transmision në vitin paraprak që rezulton nga dallimet ndërmjet vëllimit të pritur dhe real që ka rrjedhur përmes rrjetit të transmisionit në vitin paraprak (që konsiderohet të jetë jashtë kontrollit të OST-së). KOSTT-i deklaron se ky ndryshim është zbatuar vitet e kaluara dhe gjithashtu kërkohet me rregullat e çmimit të lëshuara nga ZRRE.

⁴ Vendimi V_400_2012 në dispozicion në ueb-faqen e ZRRE-së www.ero-ks.org te Aktet/Vendimet 2012.



ZRRE pajtohet se këto azhurnime do të aplikohen me Rregullen e Cmimeve në të ardhmen. Megjithatë, ZRRE thekson humbjet e lejuara për vitin 2011 janë përcaktuar me rregullat paraprake dhe asnjë azhurnim nuk është paraparë në atë kohë, azhurnimet do të aplikohen në të hyrat aktuale dhe të hyrat e lejuara për vitin 2012 e më tej, për të cilat do të jetë viti i parë në të cilat humbjet dhe të hyrat e lejuara në mënyrë gjenerale do të përcaktohen me Rregulla të reja të çmimeve. ZRRE për këtë arsye nuk do të bëjë azhurnime.

10 Komentet e përgjithshme

KOSTT-i komenton se nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga ZRRE ndaj kërkesë së tij për rivlerësim të aseteve që duhet të bëhet para implementimit të periudhës shumëvjeçare të kontrollimit të çmimit nga prilli 2013. ZRRE vë në pah se kjo çështje është diskutuar në një sërë takimesh bilaterale dhe se ZRRE e ka bërë të qartë pozitën e vet se kjo kërkesë nuk duhet të konsiderohet si pjesë e SHTE6 por që duhet të shtjellohet si pjesë e rishqyrtimit shumëvjeçar të çmimit.

11 Komentet teknike

KOSTT-i komenton se ekzistojnë mospërputhje ndërmjet Dokumentit të konsultimit të publikuar nga ZRRE dhe tabelat e ofruara nga ZRRE ku janë dhënë llogaritjet e detajshme. ZRRE nuk është në gjendje t'i përgjigjet këtij komenti para se KOSTT-i të identifikojë saktësisht se cilave mospërputhje iu referohet.

12 Propozimet e ZRRE-së

Vlerësimi i ZRRE-së për komentet e ofruara nga KOSTT-i është se këto arsyetojnë ndryshimin e dy propozimeve fillestare të parashtruara në Dokumentin e ZRRE-së për konsultim:

- Rritjen në shpenzimet e stafit prej €0.876 milionë, RAB për €6.0 milionë dhe RABf për €3.4 milionë si dhe të humbjeve në transmision prej 13 GWh pas transferim të aseteve 110kV nga KEK-u te KOSTT-i.

Përmbledhja e kërkesës fillestare të pranuar nga KEK-u, propozimeve fillestare të dhënë në Dokumentin e ZRRE-së për konsultim si dhe të propozimeve fillestare të përcaktuar në përputhje me këtë Dokument të përgjigjeve është dhënë në vijim. Këto tabela ofrojnë zberthimin gjegjësisht analitikën ndërmjet të hyrave të lejuara të propozuara dhe atyre të lejuara për dy biznese të veçanta të licencuara të KOSTT-it.

Tabela 1: Përmbledhja e kërkesave dhe propozimeve mbi të hyrat e lejuara

<i>€ milionë euro përveç nëse ceket ndryshe</i>	Lejuar në 2011	Kërkesa	Prop. fillest. të ZRRE-së	Komentet e KOSTT-it	Propozimet e ZRRE-së
KOSTT OST + OT					
Shpenzimet O&M pa zhvlerësim		9.5	5.3	6.6 (a)	6.0 (a)



€ milionë euro përveç nëse ceket ndryshe

	Lejuar në 2011	Kërkesa	Prop. fillest. të ZRRE-së	Komentet e KOSTT-it	Propozimet e ZRRE-së
Zhvlerësimi		5.3	4.3	4.6 (b)	4.6 (b)
Fitimi i lejuar		1.9	2.2	2.8 (b)	2.6 (b)
Blerja e humbjeve në transmision		4.1	3.9	4.5 (b)	4.4 (c)
Të hyrat e parregulluara		0.0	0.0	0.0	0.0
Ndryshimet tjera		-0.3	-0.7	-0.5	-0.7
KOSTT MAR	12.8	20.5	14.9	17.9	17.3

Shënimet

- a Përfshin shpenzimet e stafit të bartura nga KEK-u te KOSTT-i
- b Ky ndryshim rezulton nga inkorporimi i transferim të aseteve 110kV nga KEK-u te KOSTT-i.
- c Ky ndryshim rezulton nga inkorporimi i transferim të aseteve 110kV nga KEK-u te KOSTT-i dhe rritja e kostos mesatare të blerjes së energjisë me shumicë që ka rezultuar nga rritja e kostove të lejuara të Divizionit të Minierës dhe të Gjenerimit si pasojë e rritjes së tantimës nga janari 2013 (shih Raportin Konsultativ të KEK-ut për më shumë informacione).